



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA PËRMET**  
**KOORDINATORI PËR KONSULTIMIN PUBLIK**

Datë 25/07/2025

**PROCES VERBAL**

**Takimi i GMS për rishikimin e Planit të Integritetit 2022-2025 dhe hartimit të Planit të Integritetit 2025-2027 Bashkia Përmet**

**Vendi :** Zyra e Kryetarit të Bashkisë, Përmet

**Ora :** 11:00

**Tema e konsultimit :** Plani i Integritetit 2025-2027 Bashkia Përmet

I mbajtur sot më datë 25 Korrik në zyrën e Kryetarit të Bashkisë ku të pranishëm janë Grupi i Menaxhimit Strategjik të Bashkisë Përmet. Ky takim u zhvillua me qëllim njohjen e Grupit me Raportet e monitorimit të Planit të Integritetit për vitet 2022-2025 duke rishikuar objektivat dhe risqet dhe ngjarjet e mundshme.

Takimi nisi me fjalën e Kryetares e cila cilësoi rishikimin e Planit të Integritetit dhe hartimin e Planit të ri sa më shpejtë duke bashkëpunuar secili sektor me njëri-tjetrin. Në vijim u bë prezantimi i Planit të mëparshëm nga Koordinatori i Grupit të Punës zv. Kryetarit z. Florand Hasani.

Pas prezantimit diskutimi kaloi në drejtuesit e secilit sektor të cilët propozuan të kishin një afat për të riparë me kujdes të gjitha objektivat dhe të propozoheshin në takimin e radhës.

Koordinatori i Grupit të punës në bashkëpunim me Drejtorinë e Projekteve Integritetit Evropian/ Performancës dhe Dixhitalizimit të të dhënave sugjeruan që do të bënin një Draft të Planit të ri dhe një Formular vetëvlerësimi për tu plotësuar nga secili sektor, me qëllim dokumentimin e sugjerimeve dhe reflektimin e tyre në planin e ardhshëm.

Drejtoria e Projekteve propozoi një element të rëndësishëm sic është Transparenca dhe Llogaridhënia e cila duhet të jetë një objektiv shtesë në Planin e ardhshëm.

Takimi u mbyll me dakordësinë për vetëvlerësimin nga secili sektor dhe prezantimin në takimin e radhës.

Takimi u mbyll në orën **11:45**.

**Konceptoi: Koordinatori i Konsultimit Publik**

**Albion Naska**

**SEKRETARI PËRGJITHSHËM**

**Denisa DURRO**





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA PËRMET**  
**KOORDINATORI PËR KONSULTIMIN PUBLIK**

Datë 20/08/2025

**PROCES VERBAL**

**Takimi i Grupit të Punës për diskutimin mbi hartimin e Planit të Integritetit 2025-2027**

**Bashkia Përmet**

**Vendi** : Salla e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak, Përmet

**Ora** : 13:00

**Tema e konsultimit** : Plani i Integritetit 2025-2027 Bashkia Përmet

I mbajtur sot më datë 20 Gusht në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak, ku të pranishëm janë Grupi i Punës me Urdhër të Kryetarit Nr. 310 datë 06.08.2025.

Ky takim u zhvillua me qëllim njohjen e Grupit të punës me Draft Planin e Integritetit në të cilin janë reflektuar të gjitha sugjerimet nga sektorët e Bashkisë Përmet.

Takimi nisi me prezantimin nga Koordinator i Grupit të punës zv/Kryetari duke treguar të gjitha ndryshimet e reflektuara në Planin e ri.

Kryetarja e Bashkisë theksoi se ashtu sic është cituar në Urdhrin e Grupit të Punës të gjithë sektorët e përfshirë dhe personat përgjegjës për cdo sektor, do të kenë angazhim në vijim për zbatimin dhe monitorimin e Planit dhe Raportimin pranë Këshillit Bashkiak pas një periudhë 1 vjecare zbatimi.

Sektorët shprehën dakordësi për problematikat e reflektuara si risqe në objektivat e Planit.

Në vijim Drejtoria e Projekteve do të paraqesë një prezantim të Planit për Komisionin e Këshillit Bashkiak si një process përpara miratimit në mbledhjen e Këshillit Bashkiak.

Takimi u mbyll në orën **14:30**.

**Konceptoi: Koordinator i Konsultimit Publik**

**Albion Naska**

**SEKRETARI PËRGJITHSHËM**

**Denisa DURRO**



**Foto nga takimi:**